



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

viti shkollor 2010/2011

TESTI 3

GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË NË TEST

Testi të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra, kurse për punë janë parashikuar 120 minuta. Secilën detyrë së pari lexoje me kujdes mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Së pari zgjidhi ato detyra të cilat janë të lehta për ty, e më vonë zgjidhi ato detyra të cilat për ty janë të vështira.

Lexoje me kujdes tekstin e secilës detyre sepse në të është shpjeguar në çfarë mënyre duhet të përgjigjesh. Në detyra prej teje kërkohet të rrethosh shkronjën para përgjigjes së saktë, t'i bashkosh pjesët e përgjigjesh, të shkruash diçka etj.

Gjithnjë përdor emërtimet e plota me rastin e zgjidhjes së detyrave, shkurtesat nuk janë të lejueshme (psh., duhet të shkruash: rrethanori i vendit, e jo rr.v.).

Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shëno asgjë, ajo është hapësirë në të cilën shënohet numri i pikave.

Në këtë dhe në faqen e fundit mos shkruaj asgjë.

Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Detyrat zgjidhi së pari me laps grafit sepse kështu ke mundësi që, nëse e vëren gabimin, këtë gabim ta korrigjosh.

Para se që e dorëzon testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaj me stilolaps.

Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk do të pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë dhe e cila është korrigjuar me laps kimik.

Nëse e mbaron testin më herët, dorëzoja testin arsimtarit kujdestar dhe dil ngadalë që të mos i pengosh shokët.

Të dëshirojmë sukses në provim!

1. Lexoje tekstin dhe rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

a) Fjala e Skënderbeut kur u kthye në Krujë, ashtu siç na e jep M. Barleti, është një shembull i gojëtarisë politike. Zgjidhimi i ndërgjegjes kombëtare në luftën për liri, që ishte qëllimi kryesor i Rilindjes, i dha hov këtij stili. Nga Enqiklika (letër qarkore) e N. Veqilharxhit (1846) arrijmë deri te vepra e shquar e S. Frashërit “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”.

Pas vitit 1944 ky stil iu nënshtua tërësisht vetëm një ideologjie.

Me vendosjen e pluralizmit politik, ka një gjallërim të këtij stili, që i bën më të mprehta edhe shfaqjet e tij gjuhësore.

b) Një mesjetë si gjuhë e shkencës përdorej latinishtja. Prandaj edhe humanistët shqiptarë, si Barleti, Tomeu, Gazulli, i kanë hartuar latinisht veprat e tyre. Pjetër Bogdani është i pari që ka punuar me vetëdije për prozën shkencore shqipe.

Gjatë Rilindjes Kombëtare mendimi shkencor u përpunua sidomos për historinë, për kulturën dhe për nevojat e shkollës. Pas Pavarësisë atdhetarët i vijuan përpjekjet për shkollën e në veçanti për shkencat shoqërore. Shkencat shqiptare u zhvilluan në gjerësi pas Luftës së II Botërore. Sot proza shkencore ka arritur një nivel të kënaqshëm. Botohen revista e libra shkencorë dhe fjalorë të posaçëm.

a) stili i letërsisë artistike

b) stili politiko-shoqëror

c) stili shkencor-technik.

d) stili shkencor

Për cilat stile bëhet fjalë në këto dy tekste:

a) _____

b) _____



2. Edhe pse jo shumë i njohur për opinionin kosovar, Patrick Nou do të jetë njëri nga tre anëtarët e jurisë së emisionit të talentëve gjermanë, i ngjashëm si “American Idol” në SHBA, “Deutschland Sucht Den SuperStar”.

Shqiptari i lindur në Zvicër, Patrick Nou, i cili ka prejardhje nga Gjakova, gëzon famë të jashtëzakonshme në Evropën e Mesme, ndërsa tani do të jetë përkrah legjendës gjermane Dieter Bohlen dhe këngëtares tjetër Fernanda Bardao në spektaklin e televizionit gjerman RTL, i cili transmetohet çdo të shtune dhe të mërkure.

Nou është bërë i njohur me hitet e tij “5 Days” dhe “Beautiful”, ndërsa nuk e ka lënë pas as modelimin, ku ishte jashtëzakonisht i suksesshëm. Ai ishte i martuar me yllin holivudian, Mally Schade

- Ku ka lindur shqiptari, Patrick Nou?
- Shkruaj cilat janë hitet e tij më të njohura?
- Me kë ishte i martuar ai?

3. Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm dhe përgjigju:

- Gjuha shqipe.....5
- Gjuha e folur dhe gjuha e shkruar7
- Regjistrat e gjuhës12
- Nga fjala te teksti.....14
- Veçoritë e gjuhës letrare dhe të folur20

Fjalitë e mësipërme janë:

- parathënie
- literaturë
- përmbajtje
- titulli i librit

4. Lexo përkufizimet e mëposhtme dhe përgjigju cili prej tyre u referohet emocioneve:

- shtytje e brendshme e personit për veprime të ndryshme
- mundësia e përqendrimit të proceseve psikike në një objektiv
- përjetime personale të këndshme ose të pa këndshme
- përjetim i ngjarjeve si rrezikim fizik ose psikik i mirëqenie sonë

5. Lexoni diskutimin e mëposhtëm të tre shokëve: Andit, Aurelit dhe Besmirit dhe përgjigjuni çfarë diskutimi është:

Tema: Sporti i vërtetë

Andi: Të rrëshqasësh me ski, sigurisht që është një sport i bukur. Kurse boksi, unë mendoj se është – kur godasin, kur gjakosen – jo ai nuk quhet sport. Të bësh ski, psh., mbetet gjithnjë në sport, po të gjakosesh me grushta...

Aureli: - Këto thua gjithmonë ti, po ama vetëm ti mendon se boksi nuk është sport, se boksierët nuk janë sportistë. Ti nuk e ke idenë, se nuk sheh qoftë edhe në televizor boksi. Ti ende nuk di çështje ringu, prandaj, meqë s'di gjë, më mirë mos fol fare,

Heshtje...

Besmiri: - Unë qeshë një herë me babanë në një ndeshje boksi, por nuk më tërhoqi fare. Shkuam shumë kohë para ndeshjes dhe na u desh të prisnim gjatë. Kur më në fund filloi ndeshja, të gjithë u ngritën në këmbë dhe filluan të bërtitnin. Kështu, unë nuk pashë asgjë...

Ky diskutim është:

a) shpjegues,

b) argumentues

c) përshkrues

6. Fjalja e dhënë i takon stilit bisedimor, jo formal. Zëvendëso ose plotëso disa fjalë ashtu që fjalja të mund të përdoret edhe në situata formale zyrtare.

Shoferi dje ia shkeli gazin.

7. Shkruaj korrekt fjalitë e mëposhtme duke marrë parasysh rregullat e drejtshkrimit.

1. këtë vit u mbushën 15 vjet qysh kur në ulqin ka nisur një veprimtari letrare me emrin kalimerja poetike organizuar nga shoqata e art club-it nga ulqini.

2. jemi dy qind vjet më pas kur bajroni botoi këngët e para të kryeveprës së tij ku përmend shqipërinë e shqiptarët.

8. Shkruaj me shkronja këta numra:

48 _____

128 _____

500 _____

XII _____

9. Nëse është theksuar vetia tipike për gjuhën e folur, në vijë pranë saj shkruaj “F”, kurse nëse është tipike për gjuhën e shkruar, shkruaj “SH”:

a) Realizohet në dialog. _____

b) Është formal (zyrtar). _____

c) Plotësohet me gjeste dhe me mimikë. _____

d) Fjalitë i ka më të gjata dhe më të ndërlikuara. _____

10. Nëse shkurtesa është shkruar si duhet, në vizën pranë saj shëno S, e nëse nuk është shkruar saktë, shkruaj G.

etj (e të tjera) _____

Nr. (numër) _____

psh. (për shembull) _____

dr. (doktor) _____

fq (faqja) _____

11. Shiko fjalinë e mëposhtme dhe nënvizo theksin e fjalive:

– Sa do të rrish? Ku ndodhet shpata e Skënderbeut?

– Jepjani Andit ta vizatojë.

Në cilat fjalë bie theksi te fjalitë pyetëse dhe te fjalitë urdhërore?

Nënvizoni theksin në fjalitë e mësipërme:

12. Rradhit fjalët e fjalisë sipas llojit në shembullin e dhënë:

Nxënësi i mirë zgjohet herët në mëngjes

Nxënës emër

I mirë _____

Zgjohet _____

Herët _____

Në _____

Mëngjes _____

13. Foljet në kllapa përdori në kohën e kryer të thjeshtë:

Genci (blej) dy bileta për ndeshjen e futbollit.

(Dal) për të shëtitur nëpër rrugët e qytetit.

Ata i (përshtëndes) shokët kur i (takoj) në rrugë.

Ne (nisem) nga shkolla në ora 12.

Ai (zgjohem) shumë herët në mëngjes.

14. Bashkëtingëlloret k, g, h janë:

a) buzore

b) grykore

c) qiellzore

ç) dhëmbore

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

15. Lexoni fjalinë dhe shkruani çfarë fjalësh janë fjalët e nënvizuara me shkronja të zeza:

Bobo! Dy barkat e para u afruan shpejt tek ata, ndërsa të tjerat kishin dalë afër bregut.

Emra -

Foje -

Mbiemër -

dy - numëror

përemra -

ndajfolje

pasthirmë -

16. Lexo me kujdes vargjet e mëposhtme dhe trego prej sa rrokjeve jenë përbërë këto vargje:

Edhe hana paska hupë mbas çetash;

Edhe zanat janë largue prej gurrash;

Edhe kangën paskan me bylbylat:

At-herë djelt janë dyndë e ra te buni!

a) gjashtërokëshe;

b) dhjetërokëshe;

17. Bukuria jote, leshërat e tua

posi pëndë korbi, të gjata mbi thua,

ballëtë si diell, faqetë si mollë,

qafa jot' e gjatë, mesi yt i hollë,

sisëtë si shegë, dhëmbët si thëlpënjë,

buzët si burbuqe, sytë si gështënjë,

dora si dëborë, fjala jote mjaltë,

kurmi yt i derdhur, shtati yt i naltë;

gjithë më kënaqin, të tëra t'i dua,

po zëmëra jote u bë gur për mua!

“Dashunija” Çajupi

Lexo me kujdes vargjet e më sipërme dhe trego figurën stilistike që është përdorur në këto vargje.

a) epiteti;

b) antiteza;

c) krahasimi;

d) metafora.

18. Ritregimi është:

- a) Lloj tregimtar i prozës së shkurtër letrare a publicistike, në të cilin jepen, pa hyrë në analizën e lidhjeve të brendshme të gjërave, tiparet e një njeriu, të natyrës etj. ose përshkruhet një dukuri e jetës, një ngjarje
- b) Zbërthimi i fjalëve ose i fjalive në pjesët përbërëse për të përcaktuar vlerat e tyre gramatikore, leksikore etj. veç e veç
- c) përsërit me fjalët e mia, me shkrim ose me gojë, një pjesë të lexuar ose diçka të parë a të dëgjuar.

Rretho shkronjën para përgjigjes së ritregimit.

19. Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm, pastaj përgjigju pyetjeve.

Ato prapë vështruan njëra-tjetrën në sy. Sytë e Dianës shkëlqenin si një dritare kujtimesh, kurse ato të Stelës qenë të menduar, të përshkuar nga kureshtja e jetës që s'ë njihte.

Sa ishte rritur Stela! Jo, jo, ajo s'ishte aspak engjëll dhe, si për të pohuar këtë mendin- të fundit të së motrës, papritur Stela pyeti

- Po ti Diana ke shëtitur me djem atje?

- Posi

- Po ke dashuruar?

- Eh, si të them...,

Ismail Kadare

Fragment nga romani: "Qyteti pa reklama"

Dallo motivin të cilin e ka paraqitur shkrimtari. Rretho përgjigjen e saktë:

- a) Motivin e njohjes;
- b) Motivin e hidhërimit.
- c) Motivin e vetmisë;
- d) Motivin e miqësisë;

20. Lexo me kujdes këtë fragment nga romani i Martin Auerit dhe përgjigju pyetjeve:

Atje lart në hënë, djali kërkoi për një kohë të gjatë.

Më së fundi e gjeti plakun, që po rrinte prapa një teleskopi e po shikonte poshtë në planetin blu.

- “ A je ti njeriu që nuk e vret dot arma?” –e pyeti djali plakun.
- “ Kështu them,” tha plaku.
- “ Po studioj njerëzit në planetin aty poshtë.”
- “ Si thua, a mund të rri dot me ty?” e pyeti djali.
- “ Ndoshta,” tha plaku.
- “ A kam unë ndonjë gjë të veçantë?”
- “ Po, unë s’dua të rri me dikë që mund ta godasin për vdekje. Kur më vdiqën prindërit, i derdha gjithë lotët që kisha. Mund të rrija me një qen, po sikur ta kishin vrarë edhe atë, do të vdisja nga të qarët. Mund të rrija edhe me një grua plakë, apo me një vajzë të vogël. Por as ata nuk ishin të paprekshëm nga plumbat, dhe po të ishin vrarë do të vdisja së qarit”

Ky fragment është marrë nga romani:

- A) shoqëror
- B) filozofik
- C) shkencor- fantastik
- D) historik

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:



Rezultati në testin e gjuhës shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Komisioni:

- _____
- _____
- _____
- _____

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E pplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shkruaj ✕ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	